

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE  
"BEG ALBANIA" Sh.p.k.**



**Neni 1  
Ortaku themelues**

- 1.1 Shoqeria BEG ALBANIA sh.p.k. themelohet, me shumicen e duhur te votave, nga shoqeria "BEG" S.p.A., me seli ne Rome - Piazza di Spagna Nr. 66, regjistruar ne Dhomen e Tregtise Industrise Artizanatit dhe Bujqesise se Romes me Nr. 818229, me 16 Nentor 1995, dhe eshte ortak i vetem i saj.

**Neni 2  
Emertimi**

- 2.1 Emertimi i shoqerise eshte "BEG Albania" Sh.p.k..

**Neni 3  
Forma**

- 3.1 Shoqeria themelohet ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.p.k.).

**Neni 4  
Personaliteti juridik**

- 4.1 Shoqeria fiton personalitetin juridik dhe do te zhvilloje veprimtarine e saj ne Shqiperi, ne castin e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane.

**Neni 5  
Selia**

- 5.1 Selia e Shoqerise eshte ne Tirane, Rruga "Sulejman Delvina", Pallati - ish Posta 8, ap. 23.

**Neni 6  
Objekti i veprimtarise**

- 6.1 Ne perputhje me Nenin 11, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 7973, date 26 Korrik 1995, Shoqeria dote ushtroje veprimtarine si Shoqeri Koncesionare per financimin, ndertimin dhe administrimin e impiantit hidroelektrik te Kalivacit.
- 6.2 Per te realizuar qellimet e saj Shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortaku i vetem, nga vende te tjera ose nga institucione fianciare vendase ose te huaja.

**Neni 7**  
**Kohezgjatja**



- 7.1 Shoqeria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë prej 50 (pesëdhjetë) vjetësh, duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së rrethit Tiranë.
- 7.2 Ortaku i Vetem ka të drejtën të zgjatë afatin e veprimtarisë së shoqerisë dhe/ose të prishe shoqerinë para afatit, me Vendim të tij.

**Neni 8**  
**Kapitali i shoqerisë**

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqerisë është 1.000.000 (një milion) Leke. Kapitali i shoqerisë është derdhur plotësisht.
- 8.2 Kapitali i shoqerisë është i ndarë në 100 pjesë, secila me vlerë nominale 10000 (dhjetë mijë) Leke.
- 8.3 Dërdhja e kapitalit vërtëtohet me konfermë bankare e cila depozitohet në dosjen që paraqitet për regjistrimin e shoqerisë në gjykatë.

**Neni 9**  
**Ortaku i Vetem**

- 9.1 Ortaku i Vetem, Shoqeria "BEG" Sh.a., ka të drejtë të vendosë për çështjet kryesore lidhur me objektin e veprimtarisë së Shoqerisë, siç përcaktohen me Statutin e Shoqerisë.

**Neni 10**  
**Administrimi**

- 10.1 Administrimi i shoqerisë bëhet nga një Këshill Administrativ i përbërë nga tre administratorë, si më poshtë vijon:
- Z. Francesco Becchetti, lindur në Romë me 31 gusht 1966, kodi fiskal BCC FNC 66M31 H501S, banues në Romë, Via Indonesia n. 70, Itali; **Kryetar i Këshillit Administrativ,**
  - Zj. Liliana Condomitti, lindur në Romë me 02 shtator 1941, banuese në Romë Via Indonesia n. 70, kodi fiskal CND LLN 41P42 H501R, dhe
  - Z. Manlio Cerroni, lindur në Pisoniano (RM) me 18 nëntor 1926, banues në Pisoniano (RM) Via Colle n. 42, kodi fiskal CRR MNL 26S18 G704S.



- 10.2 Kryetari i Keshillit Administrativ ka te drejten e firmes dhe te perfaqesimit ligjor te shoqerise kundrejt te treteve dhe ne gjykim .
- 10.3 Mandati i Administratoreve eshte 3 (tre) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar.
- 10.4 Kompetencat e Administratoreve percaktohen ne Statutin e Shoqerise.

#### **Neni 11**

##### **Asambleja e Ortakeve**

- 11.1 Shoqeria udhëhiqet nga Asambleja e Ortakeve, ne rast se Ortaku i Vetem do te transferoje pjese nga pjeset qe zoteron ne kapitalin e shoqerise.
- 11.2 Asambleja merr vendim me shumice absolute votash lidhur me veprimtarine e perditshme, ndersa per ndryshimet ne Statut, zmadhimin dhe/ose zvogelimin e kapitalit, shnderrimin e shoqerise ne shoqeri komandite ose ne shoqeri kolektive kerkohet unanimiteti i votave. Shnderrimi ne nje shoqeri anonime kerkon voten pro te shumices se kualifikuar.

#### **Neni 12**

##### **Bilanci. Kontabiliteti**

- 12.1 Bilanci i shoqerise pergatitet nga Administratoret ose eksperti kontabel i emeruar prej tyre dhe shqyrtohet nga Ortaku i Vetem per tu paraqitur ne Degen e Tatim Taksave brenda fundit te muajit Mars te vitit pasardhes.
- 12.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe ne monedhen Shqiptare.

#### **Neni 13**

##### **Fitimi. Dividendi.**

- 13.1 Shoqeria do te krijojë fonde rezerve per realizimin e objektit te veprimtarise.
- 13.2 Fitimet qe do te rezultojne ne mbyllje te vitit financiar, pas shlyerjes se tatimeve, do t'i mbeten Ortakut te Vetem.
- 13.3 Humbjet e shoqerise do te mbulohen deri ne kufirin e kapitalit te shoqerise. Modalitetet e transferimit te humbjeve percaktohen nga eksperti kontabel.

**Neni 14**  
**Viti financiar**

- 14.1 Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik, d.m.th. fillojne me 1 Janar dhe mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.
- 14.2 Perjashtimisht, viti i pare fianciar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin e Zyres se Tatim Taksave dhe do te mbyllet me 31 Dhjetor 2000.



**Neni 15**  
**Likuidimi**

- 15.1 Shoqeria vihet ne likuidim kur shoqeria prishet dhe procedura e likuidimit rregullohet nga dispozitat e statutit.

**Dipozita mbyllese**  
**Neni 16**

- 16.1 Mosmarveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise, ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim midis paleve, do t'i nenshtrohen juridiksionit te Gjykates kompetente shqiptare.
- 16.2 Ky Akt themelimi, eshte hartuar ne \_\_\_ kopje ne gjuhen Shqipe dhe \_\_\_ kopje ne gjuhen Italiane me fuqi te njejte ligjore. Ne rast mosmarveshjesh versioni ne gjuhen Shqipe do te kete perparesi.

**NE EMER DHE PER LLOGARI TE ORTAKUT TE VETEM**

*Alpetim Hoxha*  
*Alpetim*



# STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BEG ALBANIA" Sh.p.k.

## THEMELIMI

### Neni 1

#### Ortaku themelues

- 1.1 Shoqeria "BEG" Sh.a., me seli ne Rome - Piazza di Spagna Nr. 66, regjistruar ne Dhomen e Tregtise Industrise Artizanatit dhe Bujqesise se Romes me Nr. 818229, date 16 Nentor 1995, me shumicen e duhur te votave, ka vendosur te krijojte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne Shqiperi, Ortak i Vetem i se ciles eshte shoqeria "BEG" Sh.a.
- 1.2 Shoqeria do te funksionojte ne perputhje me normat e ketij Statuti dhe me ligjet Shqiptare ne fuqi.

## EMERTIMI - FORMA - BAZA JURIDIKE

### Neni 2

#### Emertimi

- 2.1 Emertimi i shoqerise eshte "BEG Albania" Sh.p.k..

### Neni 3

#### Forma

- 3.1 Shoqeria themelohet ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.p.k.).
- 3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me Vendim te Ortakut te Vetem.

### Neni 4

#### Personaliteti juridik

- 4.1 Shoqeria fiton personalitetin juridik dhe do te zhvilloje veprimtarine e saj ne Shqiperi, ne momentin e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane.

### Neni 5

#### Baza juridike

- 5.1 Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine ne perputhje me ligjin "Per shoqerite tregtare", me legjislacionin Shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne Statutin dhe ne Aktin e Themelimit te saj.

## OBJEKTI - SELIA

### Neni 6

#### Objekti i veprimtarise

- 6.1 Ne perputhje me Nenin 11, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 7973, date 26 Korrik 1995, Shoqeria do te ushtroje veprimtarine si Shoqeri Koncesionare per financimin, ndertimin dhe administrimin e impiantit hidroelektrik te Kalivacit.
- 6.2 Per te realizuar qellimet e saj Shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga Ortaku i Vetem, nga vende te tjera ose nga institucione financiare vendase ose te huaja.

### Neni 7

#### Selia

- 7.1 Selia e Shoqerise eshte ne Tirane, Rruga "Sulejman Delvina", Pallati - ish Posta 8, ap. 23.

### Neni 8

#### Statusi i zyrave te tjera

- 8.1 Shoqeria mund te hape filiale, dege dhe/ ose zyra perfaqesimi ne qytete te tjera Shqiptare dhe/ ose jashte shtetit.
- 8.2 Hapja e tyre dhe mbyllja eventuale vendoset me Vendim te Ortakut te Vetem te marre me shumicen e duhur te votave.
- 8.3 Zyrat e perfaqesimit dhe filialet qe mund te hapen jashte territorit Shqiptar, do te zhvillojne veprimtarine ne perputhje me ligjet e vendeve perkatese.
- 8.4 Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera qe veprojne aktualisht apo ne te ardhmen ne territorin e Republikes se Shqiperise.

## KOHEZGJATJA - KAPITALI I SHOQERISE

### Neni 9

#### Kohezgjatja

- 9.1 Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe prej 50 (pesedhjetë) vjetesh, duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit Tirane.
- 9.2 Ortaku i Vetem ka te drejten te zgjase afatin e veprimtarise se shoqerise dhe/ ose te mbylle shoqerine para afatit, vetem me nje Vendim te marre prej tij.



## **Neni 10**

### **Kapitali i shoqerise**

- 10.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000.000 (nje milion) Leke. Kapitali i shoqerise eshte derdhur plotesisht.
- 10.2 Kapitali i shoqerise eshte i ndare ne 100 pjese, secila me vlere nominale 10000 (dhjete mije) Leke.
- 10.3 Derdhja e kapitalit vertetohet me konferme bankare e cila depozitohet ne dosjen qe paraqitet per regjistrimin e shoqerise ne gjykate.

## **Neni 11**

### **Zmadhimi i kapitalit te shoqerise**

- 11.1 Zmadhimi i kapitalit te Shoqerise vendoset me Vendim te Ortakut te Vetem.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit vertetohet me dokument bankar nese derdhet ne para, kurse ne rastin e zmadhimit te kapitalit me kontribute ne natyre behet vleresimi nga nje ekspert kontabel i caktuar sipas dispozitave te Ligjit nr. 7638, date 19 nentor 1992 "Per shoqerite tregtare".
- 11.3 Zmadhimi i kapitalit mund te behet edhe nga Asambleja e Ortakeve qe mund te krijohet ne rastin e hyrjes se ortakeve te rinj ne shoqeri.

## **Neni 12**

### **Zvogelimi i kapitalit**


- 12.1 Zvogelimi i kapitalit te Shoqerise vendoset me Vendim te Ortakut te Vetem. Ne rast se zvogelimi i kapitalit ndodh kur shoqeria do te kete Asamble Ortakesh si rrjedhoje e futjes se ortakeve te rinj, Vendimi per zvogelimin e kapitalit duhet te merret me nje shimice te kaulifikuar votash prej 3/4 te pjeseve te kapitalit te shoqerise.
- 12.2 Procdura e zvogelimit te kapitalit eshte: Administratoret e shoqerise i dorezojne ortakeve projektin per zvogelimin e kapitalit 45 dite perpara Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve. Projekti pergatitet nga Administratoret ose, nga eksperti kontabel ne rast se ka te tille.

## **Neni 13**

### **Transferimi i pjeseve te kapitalit**

- 13.1 Pjeset e kapitalit te shoqerise mund t'u cedohen apo transferohen te treteve me Vendim te Ortakut te Vetem dhe me akt noterial. Ne kete rast Administratoret therrasin nje noter per te bere legalizimin e aktit te transferimit.



- 
- 13.2 Transferimi i te gjithë pjeseve te kapitalit sjell zevendesimin automatik te Ortakut te Vetem.
- 13.3 Vlera nominale e transferimit te pjeseve te kapitalit vendoset nga palet sipas vleres se tregut, por cdo licence, koncesion apo cdo e drejte e perfituar nga ana e Ortakut te Vetem mund te shtojë vleren e pjeseve qe transferohen.
- 13.4 Shoqeria mund t'ja transferoje te drejtat e saj shoqerive te tjera ne te cilen ajo eshte ortak e ose jo. Ne kete rast Vendimi merret nga Ortaku i Vetem.
- 13.5 Cdo ndryshim ne perberjen e shoqerise duhet te pasqyrohet ne Statutin e Shoqerise dhe duhet te pranohet nga Gjykata e rrethit Tirane e cila merr vendim pasi ka shqyrtuar kerkesen e paraqitur nga Kryetari i Keshillit Administrativ ose nga Administratori i Vetem.

#### **Neni 14**

##### **Pergjegjesia e kufizuar nga pjeset e kapitalit**

- 14.1 Shoqeria pergjigjet per detyrimet ndaj te treteve deri ne vleren e kapitalit te saj te regjistruar ne Regjistrin Tregtar.

#### **Neni 15**

##### **E drejta e firmes. Vula.**

- 15.1 Shoqeria ka vulen e saj e cila duhet te vendoset mbi te gjitha dokumentet e shoqerise si dhe mbi letrat/ fax-et qe u dergohen organeve shteterore apo private.
- 15.2 Vula perdoret nga Administratori i Vetem ose nga Kryetari i Keshillit Administrativ, kur e drejta e perdorimit te saj nuk i eshte lene shprehimisht, me ligj apo me kete Statut, vetem Ortakut te Vetem.
- 15.3 Administratori i Vetem ose Kryetari i Keshillit Administrativ mund te nenshkruaje dokumente qe kerkojne autorizimin nga Ortaku i Vetem, vetem pasi autorizimi te jete leshuar personalisht nga Ortaku i Vetem.
- 15.4 Ne rastin e neshkrimit nga ana e Administratorit te Shoqerise lindin detyrime per Shoqerine kundrejt te treteve.








**ORGANET DREJTUESE.  
MARRJA E VENDIMEVE.**

**Neni 16  
Ortaku i Vetem**

- 16.1 Ortaku i Vetem, Shoqeria "BEG" Sh.a., ka te drejte te vendose per cdo ceshtje lidhur me objektin e veprimtarise se Shoqerise.
- 16.2 Megjithate, Ortaku i Vetem ka te drejte per te marre vendime kryesisht mbi ceshtjet vijuese:
1. Miratimi i bilancit te shoqerise,
  2. Zmadhimi dhe/ ose zvogelimi i kapitalit te shoqerise,
  3. Emerimi apo shkarkimi i administratorit / adminstratoreve,
  4. Kerkesa per financime te ndryshme,
  5. Pergatitja dhe miratimi i planit te veprimtarise dhe te investimeve,
  6. Mbyllja e shoqerise,
  7. Shnderrimi i formes se shoqerise nga "sh.p.k." ne nje forme tjeter,
  8. Ndryshime te Statutit,
  9. Transferimi i pjeseve te kapitalit tek te tretet,
  10. Pjesemarrja ne shoqeri te tjera qe veprojne ne Shqiperi ose jashte shtetit,
  11. Pjesemarrja e te treteve ne veprimtari,
  12. Miratimi i propozimeve te bera nga administratoret per emerimin e ekspertit kontabel apo te likuidatorit, etj..

**Neni 17  
Administratrimi i shoqerise**

- 17.1 Administrimi i shoqerise mund te behet ose nga nje Administrator i Vetem ose nga nje Keshill Administrativ i perbere nga tre deri ne pese administratore.
- 17.2 Kur shoqeria administrohet nga nje Keshill Administrativ, administratoret zgjedhin nje Kryetar nga gjiri i tyre. Kryetari i Keshillit Administrativ ka te drejten e firmes dhe te perfaqesimit ligjor te shoqerise kundrejt te treteve dhe ne gjykim .
- 17.3 Mandati i Administratoreve eshte 3 (tre) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Administratoret mund te rizegjidhen ne detyre pas mbarimit te mandatit te tyre.
- 17.4 Administratori i Vetem ose Kryetari i Keshillit Administrativ ka per detyre sidomos:
- 1 - te drejtoje veprimtarine e perditshme te shoqerise,
  - 2 - te perfaqesoje shoqerine kundrejt te treteve,
  - 3 - te pergatite dhe te mbaje kontabilitetin e shoqerise,

- 
- 4 - te propozoje emerimin e ekspertit kontabel ose te likuidatorit,
  - 5 - te organizoje veprimtarine e brendshme te shoqerise dhe t'i paraqese Ortakut te Vetem raporte mbi kete veprimtari,
  - 6 - t'i propozoje Ortakut te Vetem projekte te reja per shoqerine,
  - 7 - te zhvilloje cdo veprimtari tjeter te cfaredo natyre, me autorizimin paraprak te Ortakut te Vetem.

17.4 Administratoret mbajne kontabilitetin ose e kontrollojne ate ne rast se ai pergatitet nga eksperti kontabel dhe e paraqesin per miratim tek Ortaku i Vetem brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar.

#### **Neni 18**

##### **Pergjegjesia e Administratoreve**

- 18.1 Administratoret mbajne pergjegjesi ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjit dhe te ketij Statuti.
- 18.2 Ortaku i Vetem, mund te kerkoje shperblimin e demit si edhe mund te beje padi penale kunder Administratoreve.

#### **Neni 19**

##### **Shkarkimi i Administratoreve**

- 19.1 Administratoret mund te shkarkohen nga detyra me Vendim te motivuar te Ortakut te Vetem.

#### **Neni 20**

##### **Asambleja e Ortakeve**

- 20.1 Shoqeria do te kete Asamble Ortakesh ne rast se Ortaku i Vetem do te transferoje pjese nga pjeset qe zoteron ne kapitalin e shoqerise.
- 20.2 Asambleja merr vendim me shumice absolute votash lidhur me veprimtarine e perditshme, ndersa per ndryshimet ne Statut, zmadhimin dhe/ ose zvogelimin e kapitalit, shnderrimin e shoqerise ne shoqeri komandite ose ne shoqeri kolektive kerkohet unanimiteti i votave. Shnderrimi ne nje shoqeri anonime kerkon voten pro te shumices prej 3/4.

#### **Neni 21**

##### **Bilanci. Kontabiliteti**

- 21.1 Bilanci i shoqerise shqyrtohet nga Ortaku i Vetem dhe duhet te pergatitet per t'u paraqitur ne Degen e Tatim Taksave deri ne fund te muajit Mars te vitit pasardhes.
- 21.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe ne monedhen Shqiptare.





- 21.3 Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute.
- 21.4 Shoqeria mund te marre financime nga institucione financiare ne Shqiperi ose jashte shtetit. Per kete qellim, shoqeria mund te jape si garanci hipoteka mbi pjeset e kapitalit te shoqerise ose mbi pasuri te paluajtshme.

#### **Neni 22**

##### **Fitimi. Dividendi.**

- 22.1 Shoqeria do te krijojte rezerva per realizimin e objektit te veprimtarise.
- 22.2 Fitimet qe do te rezultojne ne mbyllje te vitit financiar, pas shlyerjes se tatimeve, do t'i mbeten Ortakut te Vetem.
- 22.3 Humbjet e shoqerise do te mbulohen deri ne kufirin e kapitalit te shoqerise. Modalitetet e transferimit te humbjeve percaktohen nga eksperti kontabel.

#### **Neni 23**

##### **Viti financiar**

- 23.1 Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik, d.m.th. fillojne me 1 Janar dhe mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.
- 23.2 Perjashtimisht, viti i pare fianciar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin e Zyres se Tatim Taksave dhe do te mbyllet me 31 Dhjetor 2000.

#### **Neni 24**

##### **Marredheniet e punes**


- 24.1 Marredheniet e punesimit ne shoqeri rregullohen me kontratat e punes te lidhura sipas legjislacionit Shqiptar.

## **LIKUIDIMI**

#### **Neni 25**

##### **Likuidimi**

- 25.1 Shoqeria do te vihete ne likuidim perpara mbarimit te kohezgjatjes se saj ne rastet kur:
- i. kushtet ne Shqiperi nuk lejojne vazhdimin e veprimtarise se shoqerise,
  - ii. Ortaku i Vetem vendos te prishe shoqerine.
- 25.2 Ne rast te prishjes se shoqerise emerohet nje likuidator qe do te jete pergjegjies per likuidimin e pasurive te shoqerise dhe per te paguar kreditorët. Pas shlyerjes



perfundimtare te kreditoreve duke respektuar normat mbi radhen e preferimit te kredive, pjesa qe mbetet i perket Ortakut te Vetem.

## DISPOZITA MBYLLESE

### Neni 26

- 26.1 Mosmarveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise, ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim midis paleve, do t'i nenshtrohen juridiksionit te Gjykates kompetente shqiptare.
- 26.2 Ky Statut, eshte hartuar ne \_\_\_\_ kopje ne gjuhen Shqipe dhe \_\_\_\_ kopje ne gjuhen Italiane me fuqi te njejte ligjore. Ne rast mosmarveshjes versioni ne gjuhen Shqipe do te kete perparesi.
- 26.3 Ky Statut eshte nenshkuar nga Ortaku themelues, sot me \_\_\_\_\_ 2000.

### NE EMER E PER LLOGARI TE ORTAKUT TE VETEM

*Aljtim Arbanaj*  
*Alban*